Inbox 8
Drafts
Sent
Junk 1
Trash
Archive

Përgjigje lidhur me kërkesën për korrigjimi...

Message 1 of 64

From **erin.neziri@bashkiapuke.gov.al**
To **alfred sherri**
Date **Today 10:47 AM**

I nderuar z. Alfred Sherri,

Në përgjigje të kërkesës suaj, lidhur me pasaktësitë e konstatuara në shënimin e emrave në certifikatën e martesës, ju bëjmë me dije se verifikimi i akteve të martesës dhe korrigjimi i të dhënave në dokumentacionin e Gjendjes Civile nuk janë në kompetencën dhe përgjegjësinë e Bashkisë Pukë.

Për këtë arsye, për trajtimin e kërkesës suaj, duhet t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile ose zyrës përkatëse të Gjendjes Civile pranë institucionit përgjegjës, duke kërkuar verifikimin e aktit origjinal të martesës të vitit 2000, të regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Gjegjan, si dhe informacion mbi procedurën që duhet ndjekur për korrigjimin e pasaktësive të konstatuara.

Bashkia Pukë nuk është institucioni kompetent për shqyrtimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin!

Me respekt Erin Neziri, specialist IT, dhe kordinator per te drejten e informimit!